



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 776/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatiit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë Arben Jashari nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Komunën e Vitisë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** i bazuar apeli: Anr.776/2021, i datës 04.11.2021 i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë Arben Jashari nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Komunën e Vitisë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për Kuvendin Komunal në Viti nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në Vendvotimet 2608d/01R; 2611d/02D; 2611d/04D; 2620d/03D; 2605d/03D; 2614d/01D; 2609d/01R; 2621d/03D; 2601x/05D.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutive të votimeve në Vendvotimet si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

## A R S Y E T I M

PZAP-i, me datën 04.11.2021 ka pranuar apelin Anr. 776/2021 të parashtruar nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë Arben Jashari nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Komunën e Vitisë ne te cilin dyshon se ka shume parregullsi gjate numërimit te votave nga komisioneret e vendvotimeve pasi që i mungojnë votat e familjarëve dhe të miqve të tij. Parashtruesi i apelit thekson se i mungojnë votat nga këto vendvotime si në vijim: 2608d/01R; 2611d/02D; 2611d/04D; 2620d/03D; 2605d/03D; 2614d/01D; 2609d/01R; 2621d/03D; 2601x/05D;

Si dëshmi ka bashkangjitur Formularët e Rezultateve të Kandidateve për vendvotimet e lartcekura si dhe deklaratat e familjareve dhe miqve të cilët pretendon se e kanë votuar

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, pas shqyrtimit të pretendimeve të apelit, materialit zgjedhor dhe provave që gjinden në shkresat e lëndëve, gjeti se:

**- Apeli është i bazuar.**

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndes, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve, siç rezulton edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vete pala ankuuese, andaj mbi këtë baze dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Komunën e Vitisë për vendvotimet si në vijim: 2608d/01R; 2611d/02D; 2611d/04D; 2620d/03D; 2605d/03D; 2614d/01D; 2609d/01R; 2621d/03D; 2601x/05D; dhe rezultati i dalur nga ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve të Lokale të datës 17.10.2021.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.


Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenin 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 776/2021 më datën 06.11.2021

**Kryesuesi i Panelit**  
**Ferki Xhafari**



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.